



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVË

---

Numri i lëndës: 2020:068978

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05393554

C.nr. 2752/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Qëndresa Beqiri Murati, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F. S. P nga Obiliqi, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “K...” L.L.C, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale për Arsim me seli në Obiliq, me objekt kontesti kompensimin e shujtave gjatë punës dhe shpërblimin jubilarë, vlera e objektit të kontestit 1,718.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 29.02.2024 mori këtë:

AKTGJYKIM

- I. APROVOHET PJESËRISHT E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses F. S. P nga Obiliqi, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses, në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 30.12.2021, për gjithsej 712 ditë pune, t’ia paguaj shumën prej 1,424.00 euro, si dhe në emër të kompensimit për shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës së punës, në vlerë prej 50% të një page bazë, t’ia kompensoj shumën prej 210.50 euro, e në shumë të përgjithshme shumën prej 1,635.50 euro, të gjitha këto me kamatën në lartësi prej 8% nga data e paraqitjes së kërkesëpadiës më datë 22.04.2020 e deri në pagesën e tërësishme, në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit ligjor;
- II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses me të cilën ka kërkuar që në emër të shpërblimit jubilarë, në vlerë 50% të një page bazë, t’ia paguaj shumën mbi vlerën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën prej 83.50 euro, si a pabazuar;
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 20.00 euro.

## A r s y e t i m

Paditësja F. S. P nga Obiliqi, përmes të autorizuarit të saj, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 22.04.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Obiliqit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Obiliq, për kompensimin e shujtave ditore dhe pagës jubilarë për periudhën nga data 18.04.2017 e deri me datë 31.03.2020. Paditësja, në padi, ndër të tjera, ka theksuar se është në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura dhe atë në pozitën e mësimdhënëses në Sh.F.M.U “D...” në Obiliq, dhe se i ka plotësuar kushtet për realizimin e 50% të një page bazë ashtu siç parashihet me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, e hyrë në fuqi me datë 18.04.2017. Tutje ka theksuar se e paditura nuk ia ka paguar as shujtën për ushqim ditor dhe as shpërblimin jubilarë, ashtu siç përcaktohet në kontratën në fjalë.

Përmes parashtrësës së dorëzuar në gjykatë me datë 04.01.2024, kërkesën e padisë e ka precizuar ashtu që nga gjykata ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses në emër të shujtës ditore për ushqim, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datë 30.12.2021, për 712 ditët e pranisë në punë, t’ia kompensojë shumën prej 1,424.00 euro, si dhe në emër të shpërblimit jubilar për mbi 10 vite të përvojës së punës 50% të pagës bazë që realizon paditësja, shumën prej 294.00 euro, e në total shumën prej 1,718.00 euro.

E paditura në përgjigjen në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, duke theksuar se paditëses në bazë të KKA 2017, i takon e drejta e kompensimit të shujtave për periudhën 18.04.2017 – 31.03.2020, por që e paditura nuk ka obligim ndaj paditëses pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 17.04.2017, e në nenin 37 të së cilës është përcaktuar se *“Palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe ti respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”*, e që rrjedhimisht e paditura nuk është përgjegjëse për të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga kjo kontratë. Kjo nga se neni 90, paragrafi 5 i Ligjit të Punës, ka përcaktuar se *“Marrëveshja kolektive vlen vetëm për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”*, dhe se e paditura nuk ka marrë përsipër detyrimet e kësaj kontrate. Tutje ka theksuar se e paditura nuk ka obligim e as të drejtë të bëjë ndarje buxhetore për këto lloje të kompensimit, ngase këtë obligim e kanë akterët e përbashkët MASHT-i, SBASHK-u si dhe Ministria e Financave të cilët sipas nenit 46 të KKA 2017 të cilët bashkërisht duhet të angazhohen në sigurimin e mjeteve financiare që implikon kjo kontratë. Andaj, bazuar në të dhënat si më lart, i ka propozuar gjykatës, që padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, por nuk i ka specifikuar.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e provave të bashkangjitura padisë, si dhe pas pranimin të përgjigjes në padi, dhe parashtrësës së datës 04.01.2024, mbi precizimin e padisë, e të cilën pala e paditur e ka pranuar me datë 31.01.2024, mbështetur në nenin 8 dhe 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, porse e paditura ka ngritur çështje që kanë të bëjnë me pamundësinë e përmbushjes së detyrimit dhe mungesës së përgjegjësisë së të njëjtës për përmbushjen e këtij detyrimi si dhe faktin se e njëjta nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit. Në këtë rast kontestues është vlerësuar se nuk ka pengesa në kuptim të dhënies së vendimit meritor jashtë seance.

Nga provat e bashkangjitura padisë gjykata gjeti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, sipas kontratës së punës të datës 03.09.2018. Gjykata përmes vërtetimit mbi përvojën e punës me numër të protokollit 68/23, i datës 29.12.2023, gjeti se paditësja ka 10 vite përvojë pune. Nga lista e pagave e datës 01.01.2020, gjykata gjeti se paditësja ka pagë bazë në vlerë prej 421.00 euro, ndërsa nga vërtetimi me numër protokollit 2016/23, i datës 11.07.2022, gjykata gjeti se e njëjta në periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 30.12.2021 ka qenë gjithsej 785 ditë prezentë në punë.

Në padi, paditësja ka theksuar se nuk ka pranuar kompensimin në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë, në kohën sa ka qenë në fuqi KKAK. Nga vërtetimi i datës 11.07.2022, me numër protokollit 2016/23, lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë, gjykata gjen se paditësja për përdhën si në precizim të kërkesëpadisë nga data 18.04.2017 e deri më 30.12.2021, ka gjithsej 784 ditë të pranisë në punë, duke i shumëzuar me nga 2 euro, rrjedhimisht duke i njohur shumën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, bazuar në kërkesën e paditëses. Këtë lloj kompensimi gjykata ia njohu paditëses në harmoni me nenin 35 par.7, të KKAK-së i cili ka përcaktuar se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2(dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore”*.

Nga provat e cekura si më lartë, gjykata gjeti se paditëses F. S. P për 10 vite përvojë pune nuk i është paguar shpërblimi jubilar në vlerë të 50 % të një page bazë, kompensim ky i paraparë me nenin 35 paragrafi 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, ku është përcaktuar se punëtorët në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit dhe atë: për 10 vite të përvojës së punës, në vlerë të 50 % të një page bazë; për 20 vite të përvojës së punës, në vlerë të 75 % të një page bazë. Së këndejmi, nga gjendja faktike e vërtetuar rezultoi se e paditura ka detyrimin e pagesës së pagës jubilarë, në vlerë të 50 % të pagës bazë që ka realizuar paditësja. Faktin e lartësisë së pagës së paditëses gjykata e vërtetoi përmes listës së pagës të datës 01.01.2020 deri me 31.01.2020, ku përcaktohet paga bazë e paditëses.

Gjykata duke ju referuar Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, dispozitat e së cilës aplikohen në tërë Republikën e Kosovës, ku në nenin 35 është paraparë e drejta punëtorëve të arsimit në shpërblim jubilar dhe kompensim në emër të ushqimit, gjeti se e njëjta është e aplikueshme nga hyrja në fuqi me datë 18.04.2017. Pas skadimit të kësaj kontrate, është nxjerrë kontrata e re, e cila iu garanton punonjësve të arsimit këto të drejta.

Neni 329 par. 1 i LPK-së ka përcaktuar se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Së këndejmi, provave që kishin të bënin me vërtetimin e ekzistimit të marrëdhënies së punës, fakteve lidhur me ditët e prezencës në punë, lartësisë së pagës si dhe përvojën e punës, gjykata ua fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Nga të lartcekurat gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit aprovues jashtë seance, në kuptim të nenit 398 i LPK-së, sipas të cilit *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë*

*përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Duke qenë se ka lindur e drejta e paditëses për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës për shpërblim jubilar dhe për ushqime gjatë punës, e njëjta është legjitimuar që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, së këndejmi, paditësja e ka rolin e kreditorit, kurse e paditura rolin e debitorit. Në kuptim të nenit 245 të Ligjit nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili ka përcaktuar se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditëses, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditëses t’ia kompensoj shumën si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.*

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që refuzoi kërkesëpadinë e paditëses, mbi shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht kopjes së listës së pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës, e datës 01.01.2020, me kod 10-93093-614-0912, gjykata gjeti se paga bazë e paditëses është 421.00 euro, e jo paga bazë në lartësi prej 588.00 euro në muaj, ashtu siç është pretenduar në padi. Këtë vendosje gjykata e mbështeti në nenin 399 të LPK-së, i cili ka përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”.

Neni 7 i LPK-së, ka përcaktuar se “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”, andaj duke marrë për bazë faktin se paditësja nuk ka ofruar prova tjera në lidhje me lartësinë e pagës bazë, nga të cekurat si më lartë, këtë pjesë të kërkesëpadiës gjykata e ka refuzuar si të pabazuar.

Gjykata, pretendimet e të paditurës të ngritura përmes përgjigjes në padi se nuk kanë linjë buxhetore të ndarë për pagesën e pagave jubilarë i gjen si të pa bazuara dhe të pa mbështetura në asnjë normë ligjore të aplikueshme. Paditësit në rrugë gjyqësore kanë filluar të realizojnë një të drejtë ligjore që i garanton KKAK, kurse mungesa e linjës së veçantë buxhetore të të paditurës, si dhe pretendimi se e njëjta nuk është përgjegjëse për faktin se nuk është palë nënshkruese e kësaj kontrate, nuk mund të ketë për efekt vendosjen ndryshe.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8%, gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, sipas të cilit “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”. Ndërsa paragrafi 2 i këtij neni ka përcaktuar se “Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”, e llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë datë 13.08.2020.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet vetë, gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 463, paragrafi 1 dhe 3 të LPK – së në të cilin thuhet: “163.1 Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën. 163.3 Pala duhet ta paraqes kërkesën për pagimin e shpenzimeve

*më së voni deri në përfundimin e shqyrtimit që i paraprinë vendosjes mbi shpenzimet, e po që se është fjala për dhënien e vendimit pa u bërë shqyrtim paraprakisht, atëherë pala ka për detyrë që kërkesën për shpenzimet e procedurës ta parashtojë në propozimin mbi të cilin gjykata duhet të vendosë.” Dhe meqë paditësja në padi dhe as me parashtrësën për precizimin e saj nuk i ka specifikuar shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi që në bazë të provave në shkresat e lëndës, ta obligoj të paditurën t’ia paguaj paditëses shpenzimet e procedurës në vlerë prej 30.00 euro për emër të taksës për padi.*

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2752/2020, datë 29.02.2024

Gjyqtarja  
Qëndresa Beqiri Murati

**KËSHILLË JURIDIKE:** *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*